

Valdete Bicurri, Egzona Kadrija-Fazliu, Rajmonda Kurshumlia,
Egi's

VLERAT DHE PARIMET E SHOQËRISË

Udhëtim nëpër ditë
të veçanta

3 4



17 Shkurti



Dita e personave
me nevoja
të veçanta

ABC

Dita e Kongresit
të Alfabetit



Dita e Paqes



Dita e Tokës


LUARASI



VLERAT DHE PARIMET E SHOQËRISË
LIBRI I MËSUESIT/ MËSUESES

Valdete Bicurri, Egzona Kadrija-Fazliu, Rajmonda Kurshumlia

Libri i mësimdhënëses/mësimdhënësit

Vlerat dhe parimet e shoqërisë

Udhëtim nëpër ditë të veçanta

3 dhe 4

Përmbajtja

Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë (5 shtator)	3
Dita Ndërkombëtare e Paqes (21 shtator)	5
Dita Botërore e Postës (9 tetor)	7
Dita Botërore e Ushqimit (16 tetor)	9
Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve (20 nëntor)	11
Dita Botërore e Televizionit (21 nëntor)	13
Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara (3 Dhjetor)	15
Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve (5 dhjetor)	17
Dita Botërore e Brajit (4 janar)	19
Dita Ndërkombëtare e Arsimit (24 janar)	20
Dita Botërore e Radios (13 shkurt)	21
Dita e Pavarësisë së Kosovës (17 Shkurt)	23
Dita e Mësuesit (7 mars)	25
Dita Botërore e Ujit (22 mars)	26
Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe (6 prill)	28
Dita Botërore e Librit (23 prill)	29
Dita e Sigurisë Rrugore (9-15 maj)	31
Dita Ndërkombëtare e Familjes (15 maj)	33
Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve (1 qershor)	35
Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor)	36

Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë (5 shtator)

<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditët e veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1,3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: - dallon ditën ndërkombëtare të bamirësisë, - planifikon aktivitete bamirësie.</p> <p>Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë. Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tabela, libri, lapsi, kutia e bamirësisë, gjësendet e sjella nga nxënësit.</p>
--

Njësia mësimore: Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë.

Ora 1

Hapi i parë: kërkohet nga nxënëset/it që ta lexojnë me vëmendje thënien e paraqitur në tabelë (thënie me motive për bamirësinë): “Nëse ju bëni një punë të mirë për të tjerët, me atë dozë gëzimi, ju mund të shëroni edhe veten në të njëjtën kohë”.

Nxënëset/it do të japin mendimet e tyre për atë që kanë lexuar dhe do të tregojnë nëse kanë qenë të përfshirë në ndonjë rast bamirësie apo kanë dëgjuar për njerëz që punojnë në këtë drejtim.

Hapi i dytë: nxënëset/it udhëzohen të lexojnë rubrikën “Mësojmë” dhe, më pas, të diskutojnë rreth asaj që kanë lexuar.

Hapi i tretë: në këtë pjesë të orës nxënëset/it fillojnë plotësimin e “Fletë pune 1”, duke marrë udhëzimet e nevojshme në mënyrë që nxënëset/it të përshkruajnë sa më me lehtësi rastet se kur mund të jemi bamirës (dashuri, durim, dhurim, ndihmë, kujdes, shpresë).

Ora 2

Hapi i parë: Nxënëset/it përkujtojnë njohuritë e marra nga pjesa “Mësojmë” përmes pyetjeve të tilla si:
Në cilën datë e kujtojmë Ditën e Bamirësisë?
Çfarë qëllimi mbart në vete kjo ditë?

Hapi i dytë: Kërkohet nga nxënëset/it që të lexojnë fjalitë që kanë krijuar tek kërkesa e “Fletë pune 1”; plotësohen mendimet e lëna përgjysmë dhe përmirësohen ato që janë vënë gabim.

Hapi i tretë: Kalohet në “Fletë pune 2”. Fillimisht prezantohen nxënëset/it me hapat e krijimit të një ngjarje të bamirësisë, diskutohet me ta për temat e mundshme mbi të cilat mund të krijohet kjo ngjarje dhe lihen që të punojnë në dyshe.

Ora 3

Hapi i parë: bëhet prezantimi i ngjarjeve të krijuara; diskutohet dhe vlerësohet përcaktimi i plotë i kriterëve të vëna në fillim të detyrës.

Hapi i dytë: përcaktohet ngjarja më bukur e planifikuar; nxënëset/it japin vlerësimet e tyre.

Hapi i tretë: nxënëset/it informohen për projektin që do ta realizojnë në orën e ardhshme - “Bamirëset/Bamirësit e vegjël”. Përcaktohen gjësendet që do t’i sjellë secili nxënës, ashtu që planifikimi të jetë sa më i saktë dhe kutia të jetë sa më e mbushur.


Ora 4

Hapi i parë: Mblidhen në një kënd të klasës të gjitha gjësendet e sjella (p.sh. mjete shkollore, ushqime, veshmbathje etj.).

Hapi i dytë: Ndahen sipas kategorive në kutitë përkatëse.

Hapi i tretë: Bashkëbisedohet me nxënëset/it për ndjenjat e tyre në ato çaste dhe për mënyrën e organizimit. Kërkohet nga ta që të shkruajnë të paktën dy fjali ku shprehin më së miri mundësinë për t’u vënë në pozitën e një bamirësi.

Dita Ndërkombëtare e Paqes (21 shtator)

 <p>2 DITA NDËRKOMBËTARE E PAQES (21 SHTATOR)</p> <p>MËSOJMË</p> <p>"Dita Ndërkombëtare e Paqes" është themeluar në vitin 1981 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Dy dekada më vonë, në vitin 2001, Asambleja e Përgjithshme votoi unanimisht për caktimin e kësaj dite si periudhë të jo-dhurancës dhe armiqësisë. Kombet e Bashkuara fuqizojnë të gjitha kombet dhe njerëzit për të ndëruar këtë ditë përmes ndërprenjës së armiqësisë qëllimshme qëllimisht të saj, dhe që ta shënojnë atë përmes edukimit dhe ndërgjegjësimin të publikut për çështje që lidhen me paqen. Syrimi i saj është formimi i idealëve të paqes, si brenda një kombi, ashtu edhe midis të gjithë kombëve dhe popujve.</p> <p>"Dita Ndërkombëtare e Paqes" shënohet më 21 shtator të çdo viti, nga qendra nacionale njerëz dhe mjera organizata në të gjithë botën.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Ndërkombëtare e Paqes Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <hr/> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2,5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: - dallon ditën ndërkombëtare të paqes, - vlerëson rëndësinë e paqes në botë. Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë. Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tabela, libri, lapsi, letrat, balonat, ngjyrat etj.</p>
--	---

Njësia mësimore: Dita Ndërkombëtare e Paqes

Ora 1

Hapi i parë: diskutohet me nxënëset/it për vendet që për vite radhazi janë në gjendje lufte duke u bazuar në pikat si: mënyra e jetesës, shkollimi, zhvillimi ekonomik etj.

Hapi i dytë: lexohet pjesa "Mësojmë" dhe sqarohen informacionet e paqarta për nxënëset/it.

Kërkohej që dikush prej nxënësve ta prezantoj atë që ka kuptuar për ditën që po shënohet.

Hapi i tretë: udhëzohen nxënëset/it për plotësimin e "Fletë pune 1". Fillimisht, pyetjet mund t'u drejtohen gojarisht disa nxënësve dhe më pas mund të vazhdohet me plotësimin individual.

Ora 2

Hapi i parë: rikujtohen informacionet e marra nga ora e mëparshme përmes leximit të përgjigjeve nga "Fletë pune 1".

Hapi i dytë: Për të vazhduar plotësimin e "Fletë pune 2" kërkohet nga nxënëset/it që të gjejnë fjalë:

Emra që lidhen me paqen (p.sh. jodhunë, luftë, pëllumb, humbje etj.),

Mbiemra që lidhen me paqen (p.sh. e bardhë, e qetë, e hidhur, e gjatë etj.)

Folje që lidhen me paqen (p.sh. zgjat, fitohet, përjetohet, arrihet etj.)

Hapi i tretë: nxënëset/it fillojnë krijimin e vjershave duke u bazuar në fjalët e mësipërme dhe duke shtuar fjalë të tjera.

Ora 3

Hapi i parë: vjershat e shkruara nga nxënëset/it lexohen përpara klasës.

Hapi i dytë: disa nga vjershat më të kompletuara përzgjidhen si nxitëse të paqes.

Hapi i tretë: Informohen nxënëset/it për projektin e orës së ardhshme, përcaktohen mjetet e punës që do t'i përdorin, qoftë letrat, balonat, ngjyrat etj.


Ora 4

Hapi i parë: duke u bazuar në fotot e pjesës së projektit, nxënëset/it përcaktojnë mënyrën se si do të jenë mbështetës të paqes; diskutojnë mendimet e tyre me mësimdhënësen/in ashtu që të jenë mendime sa më të sakta dhe të përmbushura.

Hapi i dytë: vazhdohet përgatitja e punimeve nga ana e nxënësve të cilët janë gjithmonë të mbikëqyrur e të ndihmuar nga mësimdhënësja/si.

Hapi i tretë: punimet vendosen në një kënd të klasës duke krijuar “Këndin e Paqes”. Punimet të cilat mund të duken më abstrakte kërkohet që të sqarohen.

Dita Botërore e Postës (9 tetor)

 <p>3 DITA BOTËRORE E POSTËS (9 TETOR)</p> <p>MËSOJME</p> <p>9 tetori njihet si "Dita Ndërkombëtare e Postës". Shërbimet postare janë shërbimet më të vjetra dhe më të përdorshme. Ata lidhin së bashku me njerëzit, si një nevojë e domosdoshme e komunikimit: midis komuniteteve, krahasimeve e rajoneve të ndryshme.</p> <p>Në përkrahje të herëshe ato u realizon në formë të ndryshme, duke shfrytëzuar edhe rrethvënkatore dhe pozicionet gjeografike, duke përdorur sigjellë me të, me çfarë e formë të tjera. Me zhvillimin e shpejtë teknologjikë avancuar edhe mënyrat e komunikimit. Filluan të përdoren llogaritë që lëvizin me këmbë, me dritë të zëra, për dërgimin e letërve; filluan të përdoren shpirtë me bërë, dëgjues dhe orijentues, të cilat përbëjnë edhe fillimin e organizimit të shërbimit postar.</p> <p>Dokumenti i parë i shërbimit postar është gjetur në Egjiptë dhe daton rreth 255 vjet para erës sonë. Sipas kësaj dokumenti, në atë kohë shërbimi postar ishte prezencë në të gjitha kontinentet në formë të mesazheve. Për dërgimin e tyre shpesh përdorej me dritë e mull, nga një kontinent në tjetrin. Ky lloj shërbimi, sigurisht, erdhi duke u zhvilluar e përsosur si një nevojë e domosdoshme e komunikimit universale. Ai filluan të përdoren kalësi dhe kamionet me kalësi, e në rast të veçanta të shpërndarë edhe me forcë të tjerë.</p> <p>Një rëndësi të veçantë në këtë periudhë mori shpërndarja e dërgimit të mesazheve dhe mbrojtja e lagjeshve. Në shumë vende lagjet filluan të shpërndaheshin me mjete të kohës, duke transmetuar ligen në formë shpirtë ditë në mbrojtjen në cal. Në këto momente konfigurimet simbol, tan i pavarësishtshëm, i lagjetit sot shpërndarësi i postës, i cili ishte transmetuar dorë më dorë të gjithë mesazheve të shërbimit, mesazhet të cilat nuk mund t'i zëvendësojnë as teknologjia moderne e kohës së sotme.</p> <p>Me lindjen dhe zhvillimin e sistemit kapitalist, shërbimi postar u bë një domosdoshmëri komunikimit ndërmjet vendeve, që tanimë kishin një zhvillim të shpejtë industrial. Komunikimi ndërmjet industrive dhe bari të nevojshme krijon me shpejtësi të dokumenteve dhe mallrave, për rrugën dhe sigurimin e tregëve të shërbimit. Prirja e shpejtë e shërbimit të ndryshëm të ekonomisë të vendeve të ndryshme, krijojnë algjet të zhvilluar, u shpërndarë edhe me dërrësi e madhe të dokumentacionit.</p> <p>Futja e teknologjive të reja të komunikimit ndërmjet vendeve dhe njerëzve, krijuan mundësi të përsosjes së mëtejme të shërbimit postar në mbarrë botën. Përdorimi i këtyre arsyesh teknologjike edhe në realitetin e shërbimit postar ndërkombëtar në rrugën e shpejtësisë dhe cilësisë së tyre. Sigurisht, me gjithë shpërndarësi e madhe të zhvillimit të komunikimit elektronik, një postë vazhdon të jetë i parashikshëm kudo në botë, si një shërbim i domosdoshëm dhe shumë i përdorur në çdo vend.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Botërore e Postës Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <hr/> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: - dallon ditën botërore të postës, - realizon aktivitete për ditën e postës. Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë. Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tabela, libri, fletorja, lapsi, pullat postare, letrat, zarfat.</p>
---	--

Njësia mësimore: Dita Botërore e Postës

Ora 1

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënëset/it për mënyrat se si njerëzit kanë komunikuar në mes vete nëpër kohë të ndryshme. Përmenden format dhe mjetet që janë përdorur, flitet për vështirësitë gjatë këtyre formave të dërgimit të mesazheve.

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it që të përcjellin leximin e bërë me ndërprerje, të pasuar me pyetje nga mësimdhënësja/si e përgjigje nga ana e nxënësve.

Hapi i tretë: secili nga nxënëset/it bën një përmbledhje të njësisë së mësuar me së paku pesë fjali.

Ora 2

Hapi i parë: lexohen përmbledhjet e shkruara në orën paraprake nga ana e nxënësve, duke vlerësuar informacionet e nevojshme dhe thelbësore që do të duhej të shkruheshin.

Hapi i dytë: kalohet në plotësimin e "Fletë pune 1". Nxënëset/it marrin sqarimet e duhura për secilën kërkesë. Fillimisht, ata duhet të përshkruajnë rrugën e dërgimit të letrave, duke treguar format e dërgimit të saj nga e kaluara deri tani.

Fjalët që duhet t'i deshifrojnë në detyrën e tretë janë: pako e vogël, thasët, dërgesat online, pesha, pullat postare, çmimorja.

Hapi i tretë: lexohen detyrat e plotësuara dhe bëhen përmirësimet e nevojshme apo sqarimet e paqartësive.

Ora 3:

Hapi i parë: bëhet një përsëritje e ditës së shënuar duke u bazuar në pyetje të tilla si:

Kur lindën shërbimet postare?

Si u realizuan shërbimet postare në kohët më të hershme?

Ku u gjet dokumenti i parë i shërbimit postar?

A ishte i rrezikuar lajmëtari gjatë kryerjes së detyrës së tij?...

Hapi i dytë: mësimdhënësja/si, fillimisht, përgatit disa informacione për pëllumbat lajmëtarë dhe karakteristikat e tyre, i informon nxënëset/it me to dhe i udhëzon të fillojnë punën në "Fletë pune 1".

Hapi i tretë: te detyra e tretë e fletës së punës, fillimisht rikujtohen elementet kryesore të shkrimit të letrës, si: data dhe vendi, mënyra se si u drejtohem atyre që u shkruajmë, qëllimin e letrës dhe fjalët përshëndetëse. Këto janë edhe kriteret mbi të cilat nxënëset/it do të shkruajnë letrat e tyre. Nxënëset/it vazhdojnë shkrimin e letrave në mënyrë individuale.

Ora 4:

Hapi i parë: letrat e shkruara nga nxënëset/it lexohen përpara klasës; vlerësohen kriteret e dhëna në fillim të detyrës.

Hapi i dytë: prezantohen para nxënësve pullat e ndryshme postare që përdoren në vendin tonë dhe shpjegohet kuptimi i figurave përkatëse.

Hapi i tretë: informohen nxënëset/it për projektin e orës së ardhshme dhe, varësisht nga rrethanat, përcaktohet mënyra e realizimit të projektit të dhënë.


Ora 5:

Hapi i parë: nëse nxënëset/it kanë vendosur t'i shkruajnë letrat enigmatike, ata fillojnë shkrimin e tyre në fletat e shpërndara nga mësimdhënësja/si. Secila fletë duhet të ketë një numër të ndryshëm nga tjetra, ashtu që nxënësi të mos e merr më pas letrën e tij.

Hapi i dytë: zgjidhet një postier nga klasa, i cili i merr të gjitha letrat dhe i shpërndan (mundësisht të vishet me rroba që ngjasojnë me ato të postierit të vërtetë).

Hapi i tretë: nxënëset/it, me radhë, lexojnë letrat e shokëve dhe shoqeve dhe mundohen të gjejnë se kujt i përkasin ato.

Dita Botërore e Ushqimit (16 tetor)

	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Botërore e Ushqimit Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: - dallon ditën botërore të ushqimit, - argumenton rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm. Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë. Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografitë, libri, fletorja, ushqime.</p>
---	---

Njësia mësimore: Dita Botërore e Ushqimit

Ora 1

Hapi i parë: nxënëset/it sjellin në klasë fotografinë e ushqimit të tyre të parë (kur ishin bebe); diskutohet në lidhje me ato ushqime dhe përmbajtjen e tyre.

Hapi i dytë: nxënëset/it fillojnë leximin e pjesës “Mësojmë”; mësimdhënësja/si jep sqarimet e nevojshme.

Hapi i tretë: përzgjidhen katër nxënës të cilët do të dalin para klasës dhe do bëjnë prezantimin e mësimit në bazë të njohurive fillestare të marra. Më pas, ata do të kenë të drejtën që t’u parashtrojnë të tjerëve pyetje në lidhje me atë që është prezantuar.

Ora 2

Hapi i parë: udhëzohen nxënëset/it që ta plotësojnë “Fletë pune 1”, ku duhet të gjejnë emrat e ushqimeve që janë përshkruar (*patatja, limoni, sheqeri, veza, reçeli, supa, domatja, buka*).

Hapi i dytë: në letra të ndara nga ana e mësimdhënësës/it, nxënëset/it krijojnë vetë përshkrime të tilla në lidhje me ushqime të ndryshme, duke mos e treguar në mënyrë direkte emrin e ushqimit.

Hapi i tretë: lexohen përshkrimet dhe nga ana e shokëve dhe shoqeve zbulohet se cilat janë ushqimet e fshehura prapa tyre.

Ora 3

Hapi i parë: mësimdhënësja/si merr me vete ca ushqime të bëra gati, fruta apo diçka e tillë; ato nuk duhet të shihen nga ana e nxënësve, por të provohen dhe në bazë të shijes të zbulohet se për çka bëhet fjalë.

Hapi i dytë: të diskutohet me nxënëset/it për çështjen e varfërisë. Të ofrohen informacione nga ana e mësimdhënësës/it se si qëndron kjo çështje në botë dhe në vend, si dhe çfarë mund të bëjmë secili prej nesh për të ulur nivelin e varfërisë.

Hapi i tretë: bëhet një shkrim nga ana e nxënësve ku shkruhet për ushqimet e tyre më të pëlqyera dhe mungesën e tyre në përditshmëri.

Ora 4

Hapi i parë: bëhet një rikujtim i njohurive të marra më parë, duke u bazuar në pyetje të tilla si:

Me çfarë date mbahet Dita Botërore e Ushqimit?

Cili është qëllimi i shënimit të kësaj dite?

Çka është të ushqyerit sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë? etj.


Hapi i dytë: kalohet në plotësimin e "Fletë pune 2". Nxënëset/it do të kenë kohë të flasin 1 minutë për pyetjen e parashtruar. Të gjithë nxënëset/it duhet të përfshihen në dhënien e përgjigjeve.

Hapi i tretë: mësimdhënësi do të jetë personi i cili do të përgjigjet në pyetjet e dhëna në këtë fletë pune; kështu do krijohet një lidhje më e afërt me nxënëset/it që ka në klasë.

Ora 5

Kjo orë i takon të ftuarit të gjeneratës, nutricionistit. Ai do t'i shpalosë informacionet e nevojshme para fëmijëve dhe, në anën tjetër, fëmijët do të parashtrojnë pyetje që kanë të bëjnë me temën e trajtuar.

Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve (20 nëntor)

 <p>5 DITA BOTËRORE E FËMIJËVE (20 NËNTOR)</p> <p>MËSOJMI</p> <p>Të drejtat e fëmijëve janë të drejta në kuadër të të drejtave të njeriut, me vëmendje të veçantë ndaj të drejtave, mbrojtjes dhe kujdesit të veçantë që u jepet të mirëqeveritësve. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989.</p> <p>Konventat për të drejtat e fëmijës ka kuptimin e njëjtë për të gjithë njerëzit në të gjitha anët e botës.</p> <p>Pa dyshim, Eglancinë lebb është një ndër personalitetet më të njohura në fushën e të drejtave të fëmijës. Në fund të Luftës së Parë Botërore ajo themeloi organizatën "Save the Children", për të lehtësuar efektet e anës në Austro-Hungari dhe Gjermani. Ishite hartueset e tekstit të dokumentit që u bë Deklarata e të Drejtave të Fëmijës.</p> <p>Kjo ditë shënohet çdo vit, më 20 nëntor, për të promovuar bashkimin ndërkombëtar, ndërgjegjësimin e fëmijëve në mbajtje botërisht dhe përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve. Konventa e të Drejtave të Fëmijëve ndryshoi mënyrën se si shikohen apo trajtohen fëmijët. Fëmijët nuk shikohen më si një "pronë" e prindërve. Ata nuk janë të pambrojtur dhe nuk janë objekt për barmësi. Një fëmijë është një qenie njerëzore dhe me të drejtë duhet të trajtohet si e tillë.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve Rezultati i të nxënimit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënimit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënimit për orë mësimore: dallon të drejtat elementare të fëmijëve. Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tabela, libri, lapsi, fletorja, kartat.</p>
--	---

Njësia mësimore: Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve.

Ora 1

Hapi i parë: në tabelë, paraqiten (vendosen) disa raste kur fëmijëve u janë shkelur disa të drejta elementare të tyre (përmes fotografive). Diskutohet me nxënëset/it dhe gjenden të drejtat që u takojnë fëmijëve.

Hapi i dytë: nga ana e mësimitdhënëses/it jepen shpjegime mbi organizatat që u kanë dalë në mbrojtje fëmijëve për çështje të ushqimit, sigurisë dhe aspekteve të tjera. Më pas, udhëzohen nxënëset/it që në mënyrë individuale të lexojnë pjesën "Mësojmë".

Hapi i tretë: udhëzohen nxënëset/it që në fletoret e tyre të përpilojnë 4 pyetje të nxjerra nga pjesa "Mësojmë" (kjo bëhet në dyshe). Këto pyetje, pastaj, dyshet ia parashetrojnë njëra-tjetrës.

Ora 2

Hapi i parë: mësimitdhënësi përgatit karta që bashkohen mes vete me lidhjen figurë - e drejtë. Nxënëset/it udhëzohen të bëjnë bashkimin sipas lidhjes logjike të vënë në fillim.

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it të plotësojnë "Fletë pune 1". Kjo detyrë bëhet në mënyrë individuale.

Hapi i tretë: lexohen detyrat e plotësuara dhe vlerësohet se cilat janë të drejtat më të rëndësishme, ato që respektohen më shumë, si dhe ato që shkelen më shpesh.

Ora 3

Hapi i parë: mësimitdhënësi shkruan në tabelë fjalët E DREJTË dhe PËRGJEGJËSI. Nxënëset/it lihen të mendojnë për 3 minuta dhe, më pas, merren mendimet e tyre dhe shembujt që mund t'i ofrojnë.


Hapi i dytë: kalohet në plotësimin e “Fletë pune 2”; jepen sqarimet e nevojshme dhe punohet në mënyrë individuale.

Hapi i tretë: lexohen detyrat e plotësuara dhe vlerësohen për saktësinë e tyre; detyra e dytë diskutohet më shumë, pasi që nxënëset/it mund të kenë dhënë mendime të ndryshme për përgjegjësitë në lidhje me të drejtën e përcaktuar. Nxënëset/it e klasës ndahen në grupe dhe informohen për pjesën e projektit. Secilit grup i caktohet një e drejtë në lidhje me të cilën do të përgatis prezantime, sipas mundësive shkollore (hamer, Power Point etj.).

Ora 4

Nga të gjitha punimet e klasës përzgjidhet një punim, i cili, më pas, prezantohet tek nxënëset/it e gjeneratës.

Dita Botërore e Televizionit (21 nëntor)

 <p>6 DITA BOTËRORE E TELEVISIONIT (21 NËNTOR)</p> <p>MËSOJME</p> <p>Kjo ditë është shpallur si ditë e veçantë në vitin 1996, nga Komiteti e Bashkuara, dhe për herë të parë ka bërë bashkë institucionet kryesore të industrisë së medias: Unione Evropian të Transmisioneve (EBU), Asociacionin e Televizioneve Komerciale në Evropë (ACT) dhe Asociacionin e Shteteve të Televizionit dhe Radiove me bazë në Gjenevë (EGTA).</p> <p>Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, përmas rezultate që shpalli 21 nëntorin "Ditë Botërore të Televizionit", i ftoi të gjitha shtetet anëtare ta respektojnë këtë ditë, duke i miratuar që shkëmbimet globale të programeve televizive të përfundohen, ndër të tjera, për çështje të tilla si ato të paqes, sipërsisë, ekonomisë, zhvillimit social dhe mirësisë së shkëmbimit kulturor.</p> <p>Nëse në shekullin e njëzet, atëherë kur u shfaq televizioni kishte një ndikim të theksuar dhe të qartë në natyrën dhe cilësinë e jetës njerëzore, e të përditshme të njeriut, duke qenë më i informuar, më i ofrur dhe burim i rëndësishëm i informacionit, ky ndikim në ditë e sotme është zbehtuar, nga ardhja në jetë e medias online. Megjithatë, televizioni vazhdon të ketë ndikim e vet në shoqëri. Me 21 nëntor shënohet "Dita Botërore e Televizionit", e cila simbolizon komunikimin dhe globalizimin në botën bashkëkohore.</p> <p>"Dita Botërore e Televizionit" i kushtohet filozofisë që televizioni sjell në jetën tonë, si simbol i lidhjes dhe globalizimit në shekullin e 21-të.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë</p> <p>Shkalla: II</p> <p>Tema: Dita Botërore e Televizionit</p> <p>Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: dallon ditën botërore të televizionit.</p> <p>Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tabela, libri, lapsi, fletorja.</p>
---	---

Njësia mësimore: Dita Botërore e Televizionit

Ora 1

Hapi i parë: në tabelë shkruhen fjalët *televizion, radio, internet, telefon, kompjuter*. Nxënëset/it shkruajnë një shkrim të lirë, duke përdorur fjalët bazë të dhëna në tabelë.

Hapi i dytë: lexohen shkrimet e nxënësve dhe prezantohet dita botërore, e cila lexohet edhe nga ana e nxënësve përmes pjesës "Mësojmë".

Hapi i tretë: nxënëset/it, së bashku me mësimdhënësen/in, shpjegojnë rëndësinë e televizionit për përditshmërinë tonë.

Ora 2

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënëset/it në lidhje me televizionet tona, kohën që e kalojnë duke i shikuar ato dhe programet që i shikojnë zakonisht.

Hapi i dytë: udhëzohen për plotësimin e "Fletë pune 1", me kërkesën për ta vizatuar atë se çfarë po shikon personi ulur, duke i vendosur fjalët e dhëna në vendet e duhura në fjali.

Hapi i tretë: prezantohet detyra e secilit dhe diskutohet mbi pjesën e vizatimit se çfarë kanë paraqitur.

Ora 3

Hapi i parë: ndahet klasa në dy grupe, njëri do të jetë grupi "DOBITË E TELEVIZORIT", ndërsa tjetri, grupi "DËMET E TELEVIZORIT". Bëhet diskutimi në mes grupeve duke sjellë sa më shumë informacione të bindshme në lidhje me qëllimin e grupit.


Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it që të fillojnë plotësimin e "Fletë pune 2". Detyra e pare, në mënyrë individuale, ndërsa detyrën 2 e plotësojnë bashkërisht, duke dhënë sa më shumë emra televizionesh dhe emisionesh.

Hapi i tretë: nxënëset/it informohen për pjesën e projektit. Atyre u ndahen emisionet që do t'i prezantojnë, mënyrën dhe elementet e veshjes që mund t'i sigurojnë. Që të kenë detaje që u hyjnë në punë, përdorin fletë-bloku të faqja e projektit për të mbajtur shënime.

Ora 4

Nxënëset/it prezantojnë programet e tyre siç janë në të vërtetë. Ata shijojnë momentet e kaluara së bashku me një shumëllojshmëri programesh.

Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara (3 Dhjetor)

 <p>7 DITA NDËRKOMBËTARE E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA (3 DHJETOR)</p> <p>MËSOJMI</p> <p>"Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara" është ditë e cila u promovua nga Komiteti e Bashkuara në vitin 1992. Kjo ditë ka për qëllim që të ris vëzhgohen për një mëkuptim më të plotë ndaj personave të cilët kanë ndonjë kufizim të caktuar. T'i inkurajojë njerëzit që të jenë më të vetëdijshëm për të drejtat, detyrën dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara, si dhe të ris vëzhgohen për përfshirjen që sjell integrimi i personave me aftësi të kufizuara në çdo aspekt të jetës, që nga ai ekonomik, politik, social dhe kulturor.</p> <p>Dita e personave me aftësi të kufizuara nuk përfshin vetëm personat me kufizime mendore dhe fizik, por edhe më gjerë, duke filluar nga autismi, sindroma e Daunin, sëmundja multiple ekle e.</p> <p>Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, më shumë se një miliard njerëz në të gjithë botën jetojnë me aftësi të kufizuara. Këta persona, përgjithësisht, kanë më shumë probleme shëndetësore, mundësi më të pakta ekonomike, edukimi dhe arsimto akademike më të ulëta. Kjo ndodh më shumë për shkak të barrierave me të cilat ata përballen në jetën e tyre të përditshme, sesa si rrjedhojë e kushteve e aftësisë së kufizuar. Aftësia e kufizuar nuk shfaq shpesh një çorëqë e shëndetit publik, por gjithashtu, e të drejtave të njeriut dhe zhvillimit të shoqërisë. Për-pjekjet e OSH-së në për të mbështetur shfaqet në aspekte të ndryshme, reflektohen në Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2014-2021, në Raportin Botëror për Aftësinë e Kufizuar, si dhe në Konventën e të Drejtave për Personat me Aftësi të Kufizuara.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë</p> <p>Shkalla: II</p> <p>Tema: Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara</p> <p>Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon ditën ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara, - diskuton për ndihmën që mund tu jepet personave me aftësi të kufizuara. <p>Kriteret e suksesit:</p> <p>përcaktohen me nxënëset/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketat, libri, lapsi, laptop, projektor.</p>
---	--

Njësia mësimore: Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara

Ora 1

Hapi i parë: nxënësve u jepen disa etiketa, ku secili do të shkruaj vetëm një gjë që i bënë njerëzit të dallojnë nga njëri-tjetri dhe një gjë që i bënë të jenë të ngjashëm.

Hapi i dytë: diskutohen mendimet e shkruara nga nxënëset/it; shihen dallimet dhe ngjashmëritë që kemi në mes vete. Kalohet në pjesën "Mësojmë"; nxënëset/it marrin informacionet e nevojshme dhe të panjohura nga ta. Lexohet pjesa edhe nga ana e tyre.

Hapi i tretë: kalohet tek pjesa "Fletë pune 1"; udhëzohen nxënëset/it që të plotësojnë rendet e çadrave me nevoja të veçanta. Më pas duhet të shkruajnë një nevojë të tyre; preferohet të ndalohet pak më shumë te kjo pjesë që të diskutohet me tërë klasën, ashtu që nxënëset/it të vetëdijesohen që secili prej nesh ka një nevojë dhe që mund të kemi shumë të përafërta.

Ora 2

Hapi i parë: përsëriten njohuritë përmes pyetjeve të tilla si:

Nga kush u përcaktua Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara?

Cili është qëllimi i kësaj dite?

Kush mund të konsiderohet si person me aftësi të kufizuara?

Cilat janë vështirësitë me të cilat përballen këta persona?

Hapi i dytë: nxënëset/it shikojnë video në lidhje me nevojat e veçanta dhe japin mendimet e tyre për rastet që shohin, ndjenjat dhe përjetimet gjatë asaj kohe.

Hapi i tretë: udhëzohen nxënëset/it që të bëjnë një shkrim në lidhje me ndihmën dhe gjërat që mund t'i bëjmë për personat me aftësi të kufizuara.

Ora 3

Hapi i parë: mësimdhënësja/si përgatit fjalët e përziera dhe nxënëset/it duhet t'i vënë në rend sipas kuptimit (fjalitë e krijuara duhet të kenë të bëjnë me temën në fjalë).

Hapi i dytë: që personat me aftësi të kufizuara të ndihen sa më afër, fillohet me plotësimin e "Fletë pune 1", detyra e parë, ku nxënëset/it duhet t'i sqarojnë rastet e dhëna.

Hapi i tretë: nxënëset/it informohen për projektin e radhës. Ndahen për t'u përgatitur në forma të ndryshme nevojat e tilla si:

Nevoja për të parë (të verbrit),

Nevoja për të dëgjuar,

Nevoja për të folur,

Nevoja për të ecur,


Autizmi,

Sindroma Down, si dhe nevoja të tjera, në mënyrë që të krijohet një shumëllojshmëri nevojash dhe njohurish.

Ora 4

Nxënëset/it bëjnë prezantimet e përgatitura, të tjerët japin vlerësime për punët e bëra. Gjithashtu, preferohet që punimet e kompletuara të vendosen në një kënd të klasës.

Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve (5 dhjetor)

	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: vlerëson rëndësinë e vullnetarizmit për shoqërinë njerëzore. Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë. Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tabela, fletorja, libri, lapsi.</p>
---	---

Njësia mësimore: Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve

Ora 1

Hapi i parë: mësimdhënësja/si shkruan në tabelë fjalën VULLNETARËT, në mënyrë të përzier, dhe nxënëset/it përpiqen që ta gjejnë fjalën e dhënë. Më pas, japin mendimet e tyre në lidhje me njohuritë që kanë pasur.

Hapi i dytë: kërkohet nga nxënëset/it që të mendojnë disa punë vullnetare, të cilat mund t'i realizojnë brenda klasës. Mbajnë shënime në fletoret e tyre.

Hapi i tretë: shënimet e mbajtura nga ana e nxënësve lexohen përballë klasës dhe kërkohet nga ta që, në ditët në vazhdim, t'i realizojnë ato punë vullnetare.

Ora 2

Hapi i parë: sa shpesh bëjmë punë vullnetare brenda ambienteve të familjes?, - është pyetja që do të hap diskutimin me nxënëset/it, duke dhënë shembuj të rasteve të ndryshme.

Hapi i dytë: kalohet te pjesa "Mësojmë" ku, me shpjegimet e mësimdhënësës/it dhe leximin e nxënësve, merren informacionet e reja apo plotësohen ato të mëparshmet.

Hapi i tretë: udhëzohen nxënëset/it që të fillojnë plotësimin e "Fletë pune 1", përmes së cilës ata do t'i shpjegojnë punët vullnetare të paraqitura në fotografi, si dhe do të bëjnë diferencën mes punës vullnetare dhe asaj obligative.

Ora 3

Hapi i parë: rikujtohen dhe përforcohen njohuritë e marra përmes pyetjeve të tilla si:

Çka ofron Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve për njerëzit?

Çdo të thotë të jesh vullnetar?

Cilat cilësi i bart me vete një vullnetar?

A ke pasur ndonjëherë rastin të jesh vullnetar për një punë, jep shembuj.


Hapi i dytë: kalohet në plotësimin e “Fletë pune 2”, ku për çdo muaj të vitit nxënëset/it, së bashku me mësime dhënësen/in, përcaktojnë punët vullnetare në mbështetje të fjalëve të dhëna.

Hapi i tretë: në fletoret e tyre nxënëset/it shënojnë një tekst, përmes të cilit do të shpjegojnë një rast të punës vullnetare (mund të jetë rast i vërtetë apo mund të krijojnë një rast në bazë të asaj që kanë mësuar).

Ora 4

Bëhet përcaktimi i punëve vullnetare që do të bëjnë nxënëset/it gjatë orës mësimore (p.sh. një nxënës që është më i shkathët në matematikë do të bëjë një grup me nxënës që kanë vështirësi në këtë lëndë dhe do t’iu bëjë atyre ushtrime. Një nxënës do të kontrollojë bankat e secilit nxënës për të parë pastërtinë dhe mirëmbajtjen e tyre dhe për të ndihmuar me ide për një klasë me banka më të rregullta. Një nxënës, në mënyrë vullnetare, do të përcaktojë listën me libra që mund të lexohen nga ana e nxënësve. Një tjetër do ta bëjë një orar mësimor për në shtëpi, të cilin do të mund ta ndjekin të gjithë nxënëset/it për një kohë më efektive dhe më aktive.

Dita Botërore e Brajit (4 janar)

 <p>9 DITA BOTËRORE E BRAJIT (4 JANAR)</p> <p>MËSOJME</p> <p>Që nga viti 2001, Dita Botërore e Brajit shënohet më 4 janar të çdo viti. Louis Braille ngjehet si shpikësi i Alfabetit të Brajit, dedikuar personave të verbër dhe atyre me shikim të dëmtuar.</p> <p>Alfabeti i Brajt është krijuar nga pedagogu francez Louis Braille (1809-1852). Ekipi i alfabetit në rrethet që përdoren nga të verbërit. Ky alfabet u përdor për herë të parë në vitin 1829, kurse libri i parë me këtë alfabet është botuar në vitin 1837. Aktualisht alfabeti në rrethet, modifikuar dhe i përshtatur sipas veçorive të guhëve të ndryshme, është pranuar në të gjithë botën. Për formimin e shkollave, Brajt përdori sistemin e gashës pikave. Ky sistem shkrim-leximi u ndihmon shumë të verbërve për të mësuar dhe komunikuar.</p> <p>Alfabeti shpesh në gjuhën e pikave (në Brajt) është përgatitur nga Dikaver Zgju-ri dhe Liri Kamberi bazuar në alfabetin francez të Luis Brailit. Ky alfabet është miratuar nga Ministri e Arsimit në vitin 1963 si alfabeti zyrtar i të verbërve në Shqipëri. Ai u përmirësua në një variant që u përshtatet veçorive të gjuhës shqipe dhe, po atë vit, filluan të shkruhen tekste dhe para shqipe të bazuara në këtë sistem.</p> <p>Alfabeti i prëkshëm bën të mundur që edhe të verbërit të arrijnë të lexojnë, duke lu mundësuar atyre një nga të drejtat themelore të njeriut, siç është e drejta për të komunikuar.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë</p> <p>Shkalla: II</p> <p>Tema: Dita Botërore e Brajit</p> <p>Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <hr/> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon ditën e Alfabetit të Brajit, - tregon disa nga simbolet e alfabetit të Brajit. <p>Kriteret e suksesit:</p> <p>përcaktohen me nxënëset/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, guralec, fasule, etiketa kartoni, gërshërë, ngjitës etj.</p>
--	---

Njësia mësimore: Dita Botërore e Brajit

Ora 1

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënës rreth fotografisë dhe kërkohet prej tyre që ta lexojnë rubrikën “Mësojmë”, për të vazhduar më pas me pjesën tjetër të librit. Bëhen disa pyetje rreth temës:

Kush është shpikësi i Alfabetit të Brajit?

Kur është përdorur për herë të parë dhe si është i ndërtuar?

Nga kush është përgatitur Alfabeti Shqip i Brajit?

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it të punojnë në libër pjesën “Fletë pune 1”. Njihen me Alfabetin e Brajit. Fjalitë e dhëna i kthejnë në Alfabet të Brajit.

Hapi i tretë: kërkohet nga nxënëset/it të shkruajnë se çfarë mund të bëjnë për t’i ndihmuar personat e verbër. Disa nga shkrimet e nxënësve lexohen. Puna e nxënësve vlerësohet.

Ora 2

Hapi i parë: rikujtojmë përmes disa pyetjeve temën për të cilën nxënëset/it tashmë kane njohuri:


Si janë të ndërtuara shkronjat e Alfabetit të Brajit?

Alfabeti i Brajit ka vetëm shkronja apo edhe numra?

Hapi i dytë: Udhëzohen nxënëset/it të punojnë në pjesën e “Fletë pune 2”. Zgjidh barazimet duke përdorur Alfabetin e Brajit. Përgjigju në pyetje. Bëj pyetje për shokun/shoqen sipas kërkesave të dhëna.

Hapi i tretë: punohet projekti. Nxënëset/it krijojnë karta me numra, shkronja për t’ua dhuruar fëmijëve që kanë këtë vështirësi. Vlerësohet puna e nxënësve.

Dita Ndërkombëtare e Arsimit (24 janar)

 <p>10 DITA NDËRKOMBËTARE E ARSIMIT (24 JANAR)</p> <p>MËSOJMI</p> <p>"Dita Ndërkombëtare e Arsimit" është një ditë e shënuar ndërkombëtare që i kushtohet arsimit. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli 24 janarin si "Ditën Ndërkombëtare të Arsimit", në shprehje krenarie të rolit të arsimit për paqen dhe zhvillimin. Pa arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe mundësi të përjetshme për të gjithë, vendet nuk do të kenë sukses në arritjen e barazisë gjore dhe thyerjen e ciklit të varfërisë që po të pas miliona femijë, të rinj dhe të rritur. Organizata e Kombeve të Bashkuara arsimin e konsideron një të drejtë të njeriut, një të mirë dhe përgjegjësi publike.</p> <p>E ardhmja e një vendi dhe mirëqenia e qytetarëve të tij janë të lidhura drejtpërdrejt me cilësinë e arsimit që ai ofron për fëmijët dhe rininë e tij. Përvencja na bën qytetar të dobishëm të vendit tonë, arsimimi na ndihmon gjithashtu të bëhemi të përgjigjshëm dhe të vendësipër për të gjitha ato gjëra që kontribuojnë në paqen dhe mirëqenien e shoqërisë.</p> <p>Dita Ndërkombëtare e Arsimit shënohet çdo vit për të rivlerësuar arsimin në jetën tonë, si dhe për të identifikuar dhe trajtuar çështjet e arsimit në shoqëritë tona. Në një shkallë më të gjerë, gjithashtu, vlerëtohet roli i arsimit në thyerjen e barzës midis kulturave dhe vendeve, si dhe ruajtjen e paqes dhe barazisë. Qëllimi i kësaj ditë është të kushtuar arsimi në nivelin ndërkombëtar dhe që të tërheq vëmendjen e qeverive dhe popujve për rolin dhe rëndësinë që luan arsimi si një ndër njerëzit më të përshtatshëm për të shpëtuar nga varfëria.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Ndërkombëtare e Arsimit Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <hr/> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: - dallon ditën ndërkombëtare të arsimit, - vlerëson rëndësinë e arsimit, Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë. Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libër, laps, bllok, fletore.</p>
---	---

Njëësia mësimore: Dita Ndërkombëtare e Arsimit

Ora 1

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënës rreth fotografisë dhe u kërkohet të lexojnë në rubrikën "Mësojmë", për të vazhduar më pas me pjesën tjetër të librit. Bëhen disa pyetje rreth temës:

Kush e shpalli Ditën Ndërkombëtare të Arsimit?

Cilat janë qëllimet kryesore të shënimit të kësaj dite? etj.

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it të punojnë në libër pjesën "Fletë pune 1". Gjejnë se për cilën të drejtë bëhet fjalë duke u bazuar në ilustrim. Luajnë lojën sipas kërkesës së dhënë.

Hapi i tretë: kërkohet nga nxënëset/it të shkruajnë sipas kërkesës:

Përse unë duhet të jem pjesë e shkollës?

Punimet e nxënësve lexohen dhe vlerësohen.


Ora 2

Hapi i parë: udhëzohen nxënëset/it t'i renditin fjalët për të krijuar fjali me kuptim. Disa nxënës e lexojnë fjalinë e renditur.

Hapi i dytë: nxënëset/it vazhdojnë punën duke plotësuar kërkesën e ushtrimit 2. Këtë punë nxënëset/it mund ta bëjnë në dyshe.

Hapi i tretë: punohet projekti. Nxënëset/it do të shkruajnë për temën e kërkuar. Më pas, ata mund të punojnë në hamer apo të krijojnë një valixhe me mjete te ndryshme, duke vazhduar sipas kërkesave të dhëna. Puna e nxënësve vlerësohet.

Dita Botërore e Radios (13 shkurt)

 <p>11 DITA BOTËRORE E RADIOS (13 SHKURT)</p> <p>MËSOJME</p> <p>Me qëllim që të kujtohet fuqia e radios në funksion të promovimit të qasjes në informacion dhe të lirisë së shprehjes, UNESCO shpallti 13 shkurtin "Dita Botërore e Radios". Historia e Radios është ajo që arrin ta përhapur secilin nga hapat më të rëndësishëm të komunikimit, që nga zbulimi i të ashtuquajturave valë radioje e deri më sot.</p> <p>Për herë të parë, "Dita Botërore e Radios" është shënuar më 13 shkurt të vitit 2012 dhe tashmë është festë e përvitshme.</p> <p>*Radioja ende mbetet mediumi që arrin audiencën më të gjerë në të gjithë botën, në kohën më të shpejtë të mundshme. Thuhet në deklarimin e UNESCO-s.</p> <p>Radioja kuan një mision të mirëfilltë në argëtim, edukim, informim, si dhe ndihmon në popullarizimin e ndryshimeve demokratike në të gjithë globin.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë</p> <p>Shkalla: II</p> <p>Tema: Dita Botërore e Radios</p> <p>Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none">- dallon ditën botërore të radios- tregon përdorimin e radios <p>Kriteret e suksesit:</p> <p>përcaktohen me nxënëset/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, radio etj.</p>
---	---

Njësia mësimore: Dita Botërore e Radios

Ora 1

Hapi i parë: udhëzohen nxënëset/it që në heshtje të lexojnë rubrikën "Mësojmë". Më pas, bëhen pyetje rreth asaj që është lexuar. P.sh.:

Cili ishte qëllimi i UNESCO-s për shpalljen e kësaj dite?

Pse radio mbetet medium që ka audiencën më të gjerë në të gjithë botën?

Hapi i dytë: nxënëset/it vazhdojnë punën në 'Fletë pune 1', sipas kërkesave. Gjejnë dallimet dhe ngjashmëritë në mes të radios dhe TV-së. Bëjnë një intervistë të shkurtër në klasë, sipas pyetjeve të dhëna.

Hapi i tretë: duke u bazuar në kërkesën e dhënë, nxënëset/it lejohen të lëvizin lirshëm nëpër klasë dhe të realizojnë detyrën e dhënë sipas kërkesave.

Këto të dhëna prezantohen para të tjerëve.

Ora 2

Hapi i parë: përmes disa pyetjeve, rikujtojmë mësimin e mësuar. Pyetjet e mundshme:

Çka ndikon radio në edukimin dhe arsimimin e audiencës?

Cilat nga emisionet në radio i përcillni?

Hapi i dytë: nxënëset/it vazhdojnë punën në 'Fletë pune 2', sipas kërkesave. Për ta kuptuar se si ndryshon zëri në radio, plotësojnë kërkesën e dhënë.

Hapi i tretë: bëhet një bashkëbisedim me nxënëset/it për profesionin në radio dhe më pas motivohen të vizatojnë një ambient të brendshëm në radio. Vlerësohet puna e nxënësve. Nxënëset/it udhëzohen që në shtëpi t'i punojnë mjetet e nevojshme që përdoren në radio.


Ora 3

Hapi i parë: sigurohet që nxënëset/it i kanë sjell të gjitha mjetet e improvizuara për ta filluar emisionin televiziv.

Hapi i dytë: nxënëset/it krijojnë ambientin e improvizuar të radios dhe, me mjetet që i kanë punuar me karton (mikrofonin, dëgjueset etj.), fillojnë emisionin. Ata tashmë e kanë të përgatitur temën për ta zhvilluar atë.

Hapi i tretë: bëhet një vlerësim i nxënësve, të cilët konsiderohen se punën e gazetarit e kanë kryer më së miri. Kjo mund të bëhet përmes votimit nga nxënëset/it.

Dita e Pavarësisë së Kosovës (17 Shkurt)

 <p>12 DITA E PAVARËSISË SË KOSOVËS (17 SHKURT)</p> <p>MËSOJME</p> <p>Më 17 shkurt të vitit 2008 Kuvendi i Republikës së Kosovës, njëzëri, shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Në mbledhjen ku morën pjesë 109 nga gjithsej 120 deputetë, deklarimin e shpalljes së pavarësisë e lendi kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi. Mergimet e shpalljes së pavarësisë, u dërguan letra në drejtim të të gjitha qeverive të botës për të kërkuar njohjen e saj.</p> <p>Kjo shpallje pasqyrore vullnetin e popullit tonë dhe është rezultat i përjekjeve të gjata e të mundshme të tij për liri. Lufta e Kosovës (1998-1999) e vërtetoi nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, është një nga ngjarjet kryesore që çoi në shpalljen e pavarësisë së vendit tonë. Ajo solli ndërhyrjen e forcave të NATO-s, e cila edhe i dha fund kësaj luftime, duke e detyruar ushtrinë e Serbisë të largohet nga Kosova.</p> <p>Për shumicën e banorëve të Kosovës dhe përtej saj, Dita e Pavarësisë është një ditë feste dhe moment reflektimi mbi rrugën që ka ndjekur vendi ynë deri tash dhe sfida që ndodhen para nesh. Kjo ditë shënohet me ceremoni, parada ushtarake, kulme festive, ndërmerr ndaj dëshmoreve dhe ngjarje kulturore në të gjithë Kosovën.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë</p> <p>Shkalla: II</p> <p>Tema: Dita e Pavarësisë së Kosovës 17 Shkurti</p> <p>Rezultati i të nxënimit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënimit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënimit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none">- diskuton për ditën e pavarësisë së Kosovës,- dallon simbolet e Kosovës. <p>Kriteret e suksesit:</p> <p>përcaktohen me nxënëset/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, letra me ngjyra.</p>
--	--

Njësia mësimore: Dita e Pavarësisë së Kosovës

Ora 1

Hapi i parë: udhëzohen nxënëset/it që në heshtje të lexojnë rubrikën “Mësojmë”. Më pas, bëhen pyetje rreth asaj që është lexuar. P.sh.:

Kush e shpalli pavarësinë e Kosovës?

Nga kush është udhëhequr lufta në Kosovë?

Si shënohet kjo ditë në Kosovë?

Hapi i dytë: nxënëset/it vazhdojnë punën në ‘Fletë pune 1’, sipas kërkesave. Plotësojnë fjalitë sipas kërkesave të shtruar.

Hapi i tretë: vizato orën e shpalljes së pavarësisë dhe bëj ndonjë detyrë me problem. Puna e nxënësve vlerësohet.

Ora 2

Hapi i parë: përmes disa pyetjeve, rikujtojmë mësimin e mësuar. Pyetjet e mundshme:

Pse duhet të kujtohen dëshmorët tanë në këtë ditë madhështore?

Çfarë mësove më shumë për këtë ditë të veçantë?

Hapi i dytë: nxënëset/it vazhdojnë punën në ‘Fletë pune 2’, sipas kërkesave. Gjithçka rreth vendit tim, Kosovës. Disa nga punimet e nxënësve lexohen dhe vlerësohen.

Hapi i tretë: duke përdorur shkronjën “V” për fjalën e vërtetë dhe shkronjën G për fjalën gabim, plotësojnë pjesën e lexuar. Puna e nxënësve vlerësohet. Nxënësit ndahen në grupe, sipas lëndëve mësimore, për të marrë pjesë në garën e diturisë.

Ora 3

Hapi i parë: së bashku me nxënës, sigurohet të jetë gati vendi ku ata do të garojnë, sipas lëndëve, me klasë të tjera. Grupet e nxënësve mund të vishen me ngjyrë të verdhë dhe me ngjyrë të kaltër.

Hapi i dytë: kuizi i diturisë fillon duke i përcaktuar kriteret e garës dhe respektimin e rregullave të shkruara në tabelë.

Hapi i tretë: pas përfundimit të çdo gare shpallen fituesit, për të garuar me ekipin tjetër deri në fund, kur shpallet klasa fituese.

Dita e Mësuesit (7 mars)

 <p>13 DITA E MËSUESIT (7 MARS)</p> <p>MËSOJMË</p> <p>Më mars të vitit 1887, në Korçë, u hap mësonjëtorja e parë shqipe. Mësues dhe drejtor i parë i saj ishte Pandeli Sotiri. Vec tjerash, kjo ngjarje ishte një fitore e madhe për popullin shqiptar, pasi doli ndërkohë çështja e mësiminut për shkak të pushtimit osman bëhej privatisht, brenda shtëpive në mënyrë të fshetrë. Kështu, që nga ajo ditë, 7 mars festohet nga shqiptarët si dita e mësuesit për të përkujtuar atë ngjarje të rëndësishme kulturore dhe historike.</p> <p>Edhe pse në kushte të vështira nën sundimin osman, kur mësimi i gjuhës shqipe ishte repressuar dhe ndaluar, mësonjëtorja e Korçës gjendroi e hapur për qatë 20 vjet. Drejtues të saj ishin figura të njohura të Rilindjes shqiptare si: Pandeli Sotiri, Petro Nini Luarasi, Nuçi Naçi, Thoma Avrami, etj. Kontributi i madh që këta atdhetarë dhe veprimtarë të shquar dhënë për kombën, nderohet nga shqiptarë e qytetarë që ata kishin për të përhapur dijen në popull. Me ato mundësi që kishin, ata u bënë iniciatorët e krijimit të teksteve të para shkollore të dokumentuara. Ata i kushtuan një rreth të madhe pasqurje me njësit e dhura të mesimdhënies, për të bërë më tej edhe shpërndarjen të nxënësve të tyre. Të edukuar me frymën e lirisë të patriotizmit, këta nxënës do të bëheshin në të ardhmen pasuesit e denjë të ideologjisë së mësuesve të tyre dhe lufthtarë të devotshëm në luftën për liri dhe pavarësi.</p> <p>7 Marsi është ditë në të cilën të gjithë si bashku kujtojmë mësuesit tanë të parë që na mësuam shkronjat shqipe, na mësuam si ta diam dhe ta respektojmë atdheun, 7 Marsi, Dita e Mësuesit, shënohet si një ngjarje me rëndësi kulturore në të gjithë vendin.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë</p> <p>Shkalla: II</p> <p>Tema: Dita e Mësuesit</p> <p>Rezultati i të nxënësve të temës: <u>dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</u></p> <p>Rezultatet e të nxënësve për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none">- vlerëson rëndësinë e shkollës së parë shqipe,- tregon mësuesit e parë të shkollës së parë shqipe. <p>Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënës/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi etj.</p>
--	---

Njësi mësimore: Dita e Mësuesit

Ora 1

Hapi i parë: udhëzohen nxënës/it që në heshtje të lexojnë rubrikën “Mësojmë”. Pas leximit bëhen disa pyetje:

Ku është hapur shkolla e parë shqipe?

Cili ishte mësuesi i parë?

Për sa vjet rresht mbeti e hapur shkolla shqipe?

Trego disa nga vlerat e mesimdhënësve të asaj kohe?

Hapi i dytë: nxënës/it vazhdojnë punën në “Fletë pune” 1 dhe 2, sipas kërkesës:

Gjithçka rreth mësuesit tim apo mësueses sime.

Si arrijnë mësueset/it ta bëjnë botën më të mirë?

Hapi i tretë: udhëzohen nxënës/it të bëjnë kuizin për veten e tyre. Puna e tyre të vlerësohet.


Ora 2

Hapi i parë: sigurohet ambienti i përshtatshëm për mysafirin e ftuar. Nxënës/it duhet të përgatiten për ta zhvilluar debatin me Mysafirin Folës.

Hapi i dytë: para se të fillojë bashkëbisedimi, përcaktohen kriteret dhe rregullat e bashkëbisedimit. Është shumë me rëndësi që nxënës/it të dinë të mbajnë qetësinë dhe të jenë dëgjues aktiv.

Hapi i tretë: nxënës/it do të reflektojnë me një shkrim të shkurtër për organizimin. Ky shkrim mund të lexohet nga disa nxënës.

Dita Botërore e Ujit (22 mars)

 <p>14 DITA BOTËRORE E UJIT (22 MARS)</p> <p>MËSOJME</p> <p>Në 22 mars shënohet "Dita Botërore e Ujit". Kjo është përcaktuar me rezolutën e OKB-së në dhjetor të vitit 1992. Kjo ditë shënohet me qëllim të tërheqjes së vëmendjes për kujdesin ndaj ujit për përdorim dhe me qëllim të ashpërtimit të të gjithë njerëzit e botës që të ndihmojnë në administrimin dhe menaxhimin e burimeve të ujit për paqe. Për çdo vit, në "Ditën Botërore të Ujit", theksohen aspektet specifike të ujit për paqe siç janë: uji për qytete, kualiteti i ujit, ligërat ndërkufitare, uji dhe kultura etj.</p> <p>Ekspertët vlerësojnë që rreth 1.1 miliardë njerëz nuk kanë qasje në ujë për pije, kurse 2.5 miliardë njerëz nuk i kanë të siguruarat kushtet elementare higjieno-shëndetësore. Burimet e ujit do të zotësohen vazhdimisht për atëkrah të rritjes së numrit të popullsisë, ndotjes dhe ndryshimeve të klimës.</p> <p>Këshilla për përdorimin e ujit:</p> <ul style="list-style-type: none">• Kurseni ujë gjatë përdorimit personal - mos i lini rubinetet hapur gjatë pastrimit të duarve, dhëmbëve apo trupit;• Për një rrjedhje të sigurt - rreguloni gypat e ujit dhe kanalizimit, dhe raportoni rrjedhjet e mundshme në rrjetin e qytetit/fshatit;• Promovoni përdorimin racional të ujit - mbusheni mirë lavatrin përpara përdorimit, instaloni bastur sensorike në rubinetet;• Mos e ndobni ujë - mos hidhni mbaturina, vajra dhe kimikate në ujëra;• Hani ushqime lokale - blini ushqime lokale dhe produkte të cilat prodhohen me më pak ujë;• Jini kureshtarë - zbuloni se nga vjen uji juaj, si shpërndahet (vizitoni një impiant të trajtimit të ujit të pijes apo një impiant të trajtimit të ujërave të zeza).	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II</p> <p>Tema: Dita Botërore e Ujit</p> <p>Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <hr/> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none">- dallon ditën botërore të ujit,- vlerëson rëndësinë e ujit për jetë. <p>Kriteret e suksesit:</p> <p>përcaktohen me nxënëset/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, etiketa kartoni, gërshërë, ngjitës.</p>
--	--

Njësia mësimore: Dita Botërore e Ujit

Ora 1

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënës për rëndësinë e ujit për të gjitha qeniet e gjalla.

Pyetje të mundshme:

Çfarë roli luan uji në jetën e botës së gjallë?

Sa ujë pi gjatë ditës?

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it që në heshtje të lexojnë rubrikën "Mësojmë". Pas leximit, bëhen disa pyetje:

Cili është qëllimi i kësaj dite?

Përmendni disa nga këshillat e përdorimit të ujit?

Hapi i tretë: udhëzohen nxënëset/it të shkruajnë për temën: Uji dhe përdorimi i tij në jetën tonë. Disa nga shkrimet e nxënësve lexohen. Puna e nxënësve vlerësohet.

Ora 2

Hapi i parë: rikujtohen mësimet e orës së kaluar, përmes pyetjeve:

Kush e shpalli këtë ditë dhe cili ishte qëllimi?

Çka ishte kjo fjali: "Kurseni ujin gjatë përdorimit personal - mos i lini rubinetet hapur gjatë pastrimit të duarve, dhëmbëve apo trupit".

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it të punojnë në "Fletë pune 1", sipas kërkesave. Plotësimi i hapësirave të bëhet me kujdes dhe përkushtim.

Hapi i tretë: nxënëset/it do ta lexojnë plotësimin e hapësirave sipas pyetjeve dhe puna e tyre do të vlerësohet.

Ora 3

Hapi i parë: udhëzohen nxënëset/it të shkruajnë një ese të shkurtër duke përdorur fjalët e dhëna. Shkrimi bëhet në hapësirën e dhënë.

Hapi i dytë: plotësohet nga nxënësit pjesa tjetër e “Fletë pune 2” me kërkesat:

Për çfarë duhet të jemi të kujdesshëm?

Me fjalët e dhëna plotësojnë fjalitë, për të kuptuar ciklin e ujit.

Hapi i tretë: shkruajnë një pesëvargësh për ujin. Puna e nxënësve vlerësohet.


Ora 4

Hapi i parë: nxënëset/it njoftohen që do të punojnë në grupe të ndara, sipas lëndëve. Grupet do të mundohen të integrojnë të gjitha lëndët e tjera në temat e caktuara nga mësuesja/mësuesi.

Hapi i dytë: para se të fillojnë grupet punën e tyre, ndahen rolet dhe sigurohen që të kenë materialet e nevojshme për projekt. Gjatë punës, nxënëset/it vëzhgohen dhe ndihmohen sipas nevojës.

Hapi i tretë: punimet e nxënësve ekspozohen në një kënd në klasë dhe prezantohen nga grupet.

Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe (6 prill)

	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <hr/> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: - dallon ditën ndërkombëtare të sportit, - vlerëson rëndësinë e aktiviteteve sportive. Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, rekuizitat e ndryshme.</p>
---	--

Njësia mësimore: Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe

Ora 1

Hapi i parë: me nxënëset/it bashkëbisedohet përmes disa pyetjeve:

Cila nga lëndët mësimore u pëlqen më së shumti?

Nëse është lënda e Ed. Fizike, tregoni pse ju pëlqen?

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it ta lexojnë në libër pjesën "Mësojmë" dhe të bashkëbisedohet për temën përmes disa pyetjeve:

Pse sporti mund të ndikojë në ndryshimin e shoqërisë?

Kush e vendosi 6 prillin si Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe?

Cili është qëllimi i lojërave olimpike?

Hapi i tretë: kërkohet nga nxënëset/it të punojnë në "Fletë pune 1", duke u siguruar kohë të mjaftueshme për punë. Puna e nxënësve vlerësohet.

Ora 2

Hapi i parë: kërkohet nga nxënëset/it të punojnë sipas këtyre kërkesave:

Vizato dizajnin e rrobave sportive,

Trego për sportin më të pëlqyer,

Jep informacione.

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it që të bisedojnë me njeri-tjetrin dhe ta plotësojnë ushtrimin sipas kërkesës. Plotësohet edhe ushtrimi 3. Nxënëset/it, në grupe, bisedojnë për ushtrimin 4, sipas kërkesës.

Hapi i tretë: ushtrimi 5 plotësohet nga nxënëset/it individualisht. Disa nga nxënëset/it lexojnë pjesën e plotësuar.


Ora 3 dhe 4 (2 orë)

Hapi i parë: siguroheni që të gjitha rekuizitat janë gati për të filluar lojërat në fushën sportive.

Hapi i dytë: lojërat organizohen në fushat sportive, kopshte të shkollave. Ato mund të jenë garuese në mes klasave.

Hapi i tretë: nxënëset/it do të mbajnë shënime për lojërat më të pëlqyera.

Dita Botërore e Librit (23 prill)

 <p>16 DITA BOTËRORE E LIBRIT (23 PRILL)</p> <p>MËSOJME</p> <p>23 prilli është shpallur "Dita Botërore e Librit" që nga 15 nëntori i vitit 1995. Është përzgjedhur kjo datë për shkak të simbolikës së ka për letërsinë botërore. Në këtë datë të vitit 1616, lindi vëllja e dy kolumbeve të letërsisë botërore: Shakespieri në Angli dhe Miguel de Servantes në Spanjë. I pari konsiderohet si shkrimtari më i madh i të gjitha kohërave dhe vendeve; ndërsa i dyti është autori i veprës më të gërdëtyrur në botë. Kjo datë shërohet në botë që nga viti 2003, ndërsa nga viti 1995 u caktua si ditë e veçantë edhe nga Asambleja e Përgjithshme e UNESCO-s, me qëllim që të kontribuojë në miratimin e librit për të drejtat e autorit duke i inkurajuar të gjithë, e në veçanti të rinjtë për të zbuluar kënaqësinë e leximit. Kjo datë është edhe një thirrje për të mitur respektin për kontributet e paqendrueshme të autorëve dhe librit në progresin social dhe kulturor të njerëzimit.</p> <p>Suksesi i librit dhe i të drejtës autoriale varet kryesisht nga mbështetja që merr nga të shumtë faktorë: ku hyjnë autorët e librit, botuesit, mësuesit, bibliotekosët, institucionet publike dhe private, OIQ-të dhe mediat, të cilat mobilizohen në çdo vend.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë</p> <p>Shkalla: II</p> <p>Tema: Dita Botërore e Librit</p> <p>Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <hr/> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon ditën botërore të librit, - argumenton rëndësinë dhe vlerat e librit. <p>Kriteret e suksesit:</p> <p>përcaktohen me nxënëset/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, fleta, etiketa kartoni, gërshërë, ngjitës.</p>
--	--

Njësia mësimore: Dita Botërore e Librit

Ora 1

Hapi i parë: me nxënëset/it bashkëbisedohet rreth fotografisë dhe kërkohet nga ta të japin mendime për rëndësinë e librit. Një nga pyetjet e mundshme:

Trego disa nga arsyet, pse libri konsiderohet i rëndësishëm?

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it të lexojnë në libër pjesën "Mësojmë" dhe bashkëbisedohet për temën përmes disa pyetjeve:

Pse është përzgjedhur kjo datë për të folur për rëndësinë e librit?

Kujt i bën thirrje kjo datë? Etj.

Hapi i tretë: kërkohet nga nxënëset/it të shkruajnë për librin më të pëlqyer, sipas kërkesës:

Pse do t'ia preferojë shokut/shoqes tënde këtë libër për ta lexuar?

Puna e nxënësve do të vlerësohet.

Ora 2

Hapi i parë: rikujtojmë, përmes disa pyetjeve, temën për të cilën nxënëset/it tashmë janë të njoftuar.

Cila është data e Ditës Botërore të Librit?

Pse pikërisht kjo datë?

Trego disa nga arsyet, pse libri konsiderohet i rëndësishëm?

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it se si do të punojnë në fletën e parë të punës.

Pjesa e parë do të punohet individualisht kurse pjesa e dytë në dyshe.

Hapi i tretë: Puna e nxënësve vlerësohet.

Ora 3 dhe 4 (2 orë)

Hapi i parë: udhëzohen nxënëset/it se si do të punojnë në pjesën e intervistës. Ndahen rolet.

Hapi i dytë: në klasë krijohet klimë e përshtatshme për ta realizuar pjesën e intervistës së nxënësve. Kjo pjesë mund të realizohet edhe në formën e një emisioni televiziv.

Hapi i tretë: në mënyrë individuale, udhëzohen nxënëset/it që ta përfundojnë ushtrimin 2, në “Fletë pune 2”. Puna e nxënësve vlerësohet.


Ora 4

Hapi i parë: sigurohet që nxënëset/it kanë mjete të mjaftueshme për ta filluar projektin e tyre. Ata mund të ndahen në grupe pune.

Hapi i dytë: në klasë krijohet klimë e përshtatshme për ta realizuar projektin. Nxënëset/it vëzhgohen gjatë punës së tyre, duke i këshilluar sipas nevojës.

Hapi i tretë: librat e punuar nga nxënëset/it ekspozohen në një kënd të klasës dhe secili nga ta mund ta shikojë krijimin e shokut apo shoqes. Puna e nxënësve vlerësohet.

Dita e Sigurisë Rrugore (9-15 maj)

 <p>17 DITA E SIGURISË RRUGORE (9-15 MAJ)</p> <p>MËSOJME</p> <p>E organizuar nga Kombet e Bashkuara, nën moton "Heronjtë e Sigurisë Rrugore", nga data 9 deri më 15 maj, mbahet "Java e Sigurisë Rrugore".</p> <p>Përgjatë kësaj jave u bëhet theks politikëbërës, që të angazhohen për rrugë me shpejtësi më të ulët nëpër qytete në mbetësi botë, për të kultivuar shpejtësinë në 30 km/h, në vendbanime apo në zonat ku njerëzit jetojnë, punojnë dhe luajnë. Rrugët me shpejtësi të ulët krijojnë ju vetëm qytete më të sigurta, por edhe më të shëndetshme, të gjelbra dhe të përcaktueshme për të jetuar.</p> <p>"Java e Sigurisë Rrugore" u kallon të gjithë atyre që përdorin rrugët, që të marrin përgjegjësi për sigurinë e tyre dhe të tjerëve në komunikacion.</p> <p>Bëhu edhe ti hero i sigurisë rrugore, duke i respektuar rregullat e komunikacionit dhe duke i përdorur rrugët në mënyrë të sigurt!</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë</p> <p>Shkalla: II</p> <p>Tema: Java e sigurisë rrugore</p> <p>Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none">- dallon shenjat e sigurisë në trafik,- argumenton masat e sigurisë rrugore. <p>Kriteret e suksesit:</p> <p>përcaktohen me nxënëset/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, bllok fletë.</p>
---	---

Njësia mësimore: Java e Sigurisë Rrugore

Ora 1

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënëset/it rreth ilustrimit dhe kërkohet nga ta që të japin mendime rreth saj. Një pyetje e mundshme:

Kush të jep siguri në rrugë?

Hapi i dytë: nxënëset/it udhëzohen të lexojnë rubrikën "Mësojmë" dhe, më pas, të diskutojnë rreth asaj që është lexuar. Një pyetje e mundshme:

Pse veprimtaria e kësaj dite mund të bëhet përgjatë shtatë ditëve?

Hapi i tretë: kërkohet nga nxënëset/it t'i shkruajnë disa fjali për temën: Bëhu edhe ti hero i sigurisë rrugore. Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.

Ora 2

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënës rreth pyetjes:

Përmendi disa nga rregullat që të japin siguri në rrugë?

Hapi i dytë: nxënëset/it udhëzohen të punojnë në "Fletë pune 1", duke bashkëpunuar me shokun/shoqen e bankës. Puna e tyre vëzhgohet dhe ndihmohen sipas nevojës.

Hapi i tretë: nxënëset/it prezantojnë punë në dyshe para nxënësve të klasës dhe diskutohet për mënyrën e plotësimit.

Ora 3

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënëset/it për disa nga shenjat e trafikut, të cilat paraqiten para tyre me pyetjen:

Cilat nga shenjat e trafikut i njeh edhe çfarë tregojnë ato?

Hapi i dytë: nxënëset/it ndahen në grupe për të punuar në “Fletë pune 2”.

Secilit nxënës i caktohet roli në grup.

Kjo pjesë bëhet në formë të garës, sipas kohës që e përcakton mësuesi/mësuesja.

Hapi i tretë: me të përfunduar punën në grup, në formë të garës, nxënëset/it vlerësohen për punën e tyre.


Ora 4

Hapi i parë: udhëzohen nxënëset/it për rolin e tyre gjatë vizitës në autoshkollë.

Hapi i dytë: secili nga nxënëset/it do të jetë pjesëmarrës aktiv në ligjëratën që do të mbahet në autoshkollë. Ata do të mbajnë shënime e do të pyesin për çdo gjë që u intereson.

Hapi i tretë: në klasë bashkëbisedohet për informatat që janë marrë nga ligjëratat.

Dita Ndërkombëtare e Familjes (15 maj)

 <p>18 DITA BOTËRORE E FAMILJES (15 MAJ)</p> <p>MËSOJMË</p> <p>Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, ka shpallur 15 majin si "Dita Ndërkombëtare e Familjes", në mënyrë që të rishtojë ndërgjegjësimin për problemet dhe çështjet e familjes, si dhe për të ndihmuar që ato të fitojnë rol më të rëndësishëm në politikat e shteteve anëtare.</p> <p>Qëllimi i shprehur në Dita Ndërkombëtare të Familjes është promovimi i familjes dhe vlerave të saj, ruajtja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi baze e shoqërisë, si dhe ndihma familjeve për të përmbushur përgjegjësitë e tyre për komunitetin.</p> <p>Duke pasur parasysh rolin e madh që luan familja në jetën publike, e sidomos në jetën e çdo individi ekzistimi i një dite të tillë të veçantë është më se e natyrshme. Një fami që jeton në një familje, që nga kësaj mëson hapet e parë dhe modelin e sjelljes në shoqëri.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Ndërkombëtare e Familjes Rezultati i të nxënësve të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Rezultatet e të nxënësve për kompetenca kryesore të shkollës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1,3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore: - dallon ditën ndërkombëtare të familjes - kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënës/it në klasë. Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, fotografia, llaptopi etj.</p>
---	--

Njësi mësimore: Dita Ndërkombëtare e Familjes

Ora 1

Hapi i parë: kërkohet nga nxënës/it të shkruajnë një fjali për familjen, me kërkesën:

Cili është roli juaj në familje?

Lexohen disa fjali nga nxënës/it.

Hapi i dytë: nxënës/it udhëzohen të lexojnë rubrikën "Mësojmë" dhe, më pas, të diskutojnë rreth asaj që është lexuar. Disa pyetje të mundshme:

Cili ishte qëllimi i OKB-së për të shënuar këtë ditë?

Përmendni disa nga vlerat e familjes?

Hapi i tretë: kjo pjesë e orës kërkon më shumë kohë, sepse do të fillohet me plotësimin e "Fletë pune 1", deri në përfundim të orës. Puna e nxënësve kontrollon.

Ora 2

Hapi i parë: bëhet një bashkëbisedim më nxënës/it rreth temës së familjes, sipas këtyre pyetjeve:

Nga kush u shpall Dita Ndërkombëtare e Familjes?

Cili ishte qëllimi? Etj,

Hapi i dytë: udhëzohen nxënës/it të punojnë në "Fletë punë 2", sipas kërkesave.

Pjesa e parë plotësohet nga nxënësi, individualisht,

Pjesa e dytë plotësohet në dyshe.

Hapi i tretë: puna e nxënësve prezantohet para të tjerëve.

Ora 3

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënëset/it për detyrën e shtëpisë dhe për realizimin e projektit.

Një pyetje e mundshme:

Si zgjodhët ta festoni këtë festë me familjen tuaj?

Hapi i dytë: nxënëset/it do ta prezantojnë projektin e tyre para shoqeve/shokëve të klasës.

Prezantimi i tyre do të shoqërohet me fotografi në formë fizike apo përmes projektorit.

Hapi i tretë: në një kënd të klasës do të vendosen projektet e nxënësve për Ditën Ndërkombëtare të Familjes. E gjitha puna e tyre do të vlerësohet.

Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve (1 qershor)

<p>19 DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE (1 QERSHOR)</p> <p>MËSOJMË</p> <p>"Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve" është jo vetëm një ditë festive, por edhe një ditë për t'i thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët shprehin lirinë për të thënë të drejtat e tyre.</p> <p>Dita e Fëmijëve u vendos në datën 1 qershor sepse në këtë datë të vitit 1925, në Gjenevë, u mbajt Konferenca Botërore e Mësimtarëve të Fëmijëve. Dy vite më pas, 1 qershor filloi të festohet në të gjithë botën. Kjo ngjarje bëri që vëmendja e prindërve, shtetit dhe shoqërisë të drejtohej tek fëmijët, në formë reflektimi për shkollën e respektimit të të drejtave dhe mirëqenies së tyre. Në këtë ditë fëmijët bëhen gendra e botës dhe aktivitetet të shumta u kushtohen vetëm atyre. Vetë ata e ngjajnë shtet për të drejtat e tyre, por për ndryshime nga të mirat, protesta e tyre bëhet përmes lojërave festive.</p> <p>Sig thami më lartë, përveç një ditë festive, 1 Qershor është edhe një ditë sensibilizimi për të ndaluar dhunën dhe abuzimin me fëmijët, sidomos kundër angazhimit të tyre në punë kur janë ende të mitur. UNICEF, që prej vitit 1950, punon në 190 vende të botës me familjet, bashkësitë dhe qeveritë për të garantuar të drejtat e fëmijëve. Që nga viti 1989, shumë qeveri kanë adoptuar Konventën e OKS mbi të drejtat e fëmijëve, e cila garanton zbatimin dhe respektimin e të drejtave të barabarta për çdo fëmijë, me qëllim plotësimin e nevojës të tyre për mbrojtje, mirëqenie dhe përmirësimin e potencialit të tyre. Megjithatë, ende, miliona fëmijë në botë janë për e dhunës, abuzimit dhe diskriminimit, ndërsa shumë të tjerë nuk u garantojnë shëndeti, ushqimi, streha, shkolle apo ditë të reja duke u detyruar të kërkojnë tëmoshtë, përkatësisht të punojnë për logarit të të tjerëve.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore</p> <p>Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi</p> <p>Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë</p> <p>Shkalla: II</p> <p>Tema: Dita Ndërkombëtare e fëmijëve</p> <p>Rezultati i të nxënimit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <hr/> <p>Rezultatet e të nxënimit për kompetenca kryesore të shkollës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2.</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1.</p> <p>Rezultatet e të nxënimit për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - bisedon për ditën ndërkombëtare të fëmijëve, - merr pjesë në aktivitete për ditën e fëmijëve. <p>Kriteret e suksesit:</p> <p>përcaktohen me nxënëset/it në klasë.</p> <p>Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, maska të ndryshme, kostume të ndryshme.</p>
--	---

Njëësia mësimore: Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve

Ora 1

Hapi i parë: bashkëbisedohet me nxënëset/it rreth ilustrimit, me pyetjen:

Pse është e rëndësishme të dimë për të drejtat e fëmijëve?

Kërkohej nga nxënëset/it të lexojnë rubrikën "Mësojmë".

Hapi i dytë: udhëzohen të punojnë në "Fletë punë 1", sipas kërkesave. Nxënëset/it punojnë individualisht.

Hapi i tretë: nxënëset/it prezantojnë punën e tyre si dhe diskutojnë për pjesët ndryshe nga të tjerët.

Ora 2

Hapi i parë: njoftohen nxënëset/it që të punojnë në rubrikën "Fletë punë 2" – Argëtohu. Nxënëset/it marrin sqarimet e nevojshme rreth punës që do ta bëjnë.

Hapi i dytë: kjo rubrikë, "Fletë pune 2", punohet në dyshe, duke ia dhënë njëri-tjetrit kohën e caktuar për t'u përgjigjur në pyetje. Këto përgjigje i lexohen shokut/shoqes së klasës.

Hapi i tretë: në këtë pjesë të orës, udhëzohen nxënëset/it të tregojnë përjetimet që kaluan gjatë kohës së punës së përbashkët me shokun/shoqen. Përgatiten nxënëset/it për orën tjetër të projektit.

Ora 3

Hapi i parë: nxënëset/it prezantojnë, si në sfilatë mode, veshjen e tyre.

Hapi i dytë: parakalimi i karnavalit bëhet sipas vendimit të marrë nga shkolla.

Hapi i tretë: nxënëset/it do të shkruajnë për përjetimet e tyre në karnaval.

Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor)

 <p>20 DITA BOTËRORE E MJEDISIT (5 QERSHOR)</p> <p>MËSOJMI Dita 5 qershor, tash e më shumë se pesë dekada, shënon Ditën Botërore të Mjedisit kudo në botë. Kjo datë ka për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe inkurajimin e veprimit për mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal e global, si dhe nxitjen e aktiviteteve e aksioneve për të bërë ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit. Përçaktimi zyrtar i kësaj date si ditë zyrtare ishte vendosur në vitin 1972 nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, tekta fokus, zbatohet si edhe kartë, e kështu mjetet e vetëdijes rreth çështjeve mjedisore si dhe shterohen e vëmendjes së politikës ndaj këtyre çështjeve. Kujdesi për tokën dhe ujën, ndryshimet klimatike, mbrojtjen e shtresës së ozonit dhe shënimin e hapësirave të gjelbra kanë qenë vetëm disa prej temave të kësaj ngjarjeje që tanimë janë të ndryshme nga viti në vit.</p>	<p>Aspektet e përgjithshme të njësisë mësimore Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: Vlerat dhe parimet e shoqërisë Shkalla: II Tema: Dita Botërore e Mjedisit Rezultati i të nxënit të temës: dallon ditë të veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <hr/> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3; II-2, 5; III-2, 4; IV-3; V-8; VI-2. Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1, 3; 3.1; 5.2; 6.1. Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: - dallon ditën botërore të mjedisit, - vlerëson rëndësinë e kujdesit ndaj mjedisit. Kriteret e suksesit: përcaktohen me nxënëset/it në klasë. Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, lapsi, guralecë, fasule, etiketa kartoni, gërshtë, ngjitës etj.</p>
--	--

Njësia mësimore: Dita Botërore e Mjedisit

Ora 1

Hapi i parë: me nxënëset/it bashkëbisedohet rreth ilustrimit dhe kërkohet nga ta të flasin për njohuritë që kanë rreth kësaj teme. Një nga pyetjet e mundshme:

Cila është lidhja në mes të njeriut dhe bimëve?

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it që të lexojnë në libër pjesën “Mësojmë” dhe të bashkëbisedohet për temën përmes disa pyetjeve:

Kush e përcaktoi këtë datë për mjedisin dhe pse?

Cila është rëndësia e kësaj date?

Hapi i tretë: kërkohet nga nxënëset/it të shkruajnë në fletore sipas kësaj kërkese:

Çfarë keni ditur dhe çfarë mësuat rreth kësaj feste?

Di dhe Mësova.

Ora 2

Hapi i parë: diskutohet në klasë rreth fjalisë në kornizë. Të jesh I GJELBËR do të thotë të japësh ndihmën tënde në të mirë të mjedisit.

Hapi i dytë: udhëzohen nxënëset/it të punojnë në rubrikën “Përgjigju”, si dhe në rubrikën “Plotëso fjalitë me fjalët e dhëna”. Ata mund të punojnë individualisht por edhe në dyshe. Pasi të plotësohen nga nxënëset/it, lexohen disa prej tyre.

Hapi i tretë: si do të duket një mjedis ideal? Udhëzohen nxënëset/it të punojnë në grupe për të marrë sa më shumë mendime për temën. Kjo punë në grupe prezantohet para klasës

Ora 3

Hapi i parë: para se nxënëset/it ta sfidojnë veten, udhëzohen se si të punojnë me përgjigje alternative, duke e rrethuar pyetjen e saktë, si dhe të kërkojnë ndihmë për ndonjë paqartësi.

Hapi i dytë: pas udhëzimeve, nxënësit punojnë individualisht. Puna e nxënësve vëzhgohet.

Hapi i tretë: kërkohet që nxënëset/it të diskutojnë rreth kësaj sfide, sidomos për temat me të cilat kanë pasur më shumë vështirësi. Nxënëset/it informohen për punën që do ta bëjnë me projektin në orën tjetër.

Ora 4

Hapi i parë: të ndarë në grupe, nxënëset/it udhëzohen se si do të punojnë në projektin “Ambientalistët”.

Hapi i dytë: gjatë punës në grupe, nxënëset/it vëzhgohen dhe ndihmohen, sipas kërkesave të tyre. Po ashtu, vëzhgohet puna e secilit nxënës, sipas përgjegjësive që i ka në grup.

Hapi i tretë: bëhet prezantimi i punës së secilit nxënës/e. Punimet e nxënësve vendosën në një kënd të klasës.